



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 29.10.2015, në orën 12:40

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Slavko Simiq, Mexhide Mjaku-Topalli, Etem Arifi dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Etem Arifi, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu dhe Valdete Bajrami.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Sulltane Gashi, zyrtare e fushës dhe Burim Tahiri-UNICEF.

Pjesëmarrës të tjerë: Isa Hasani-IAP; Genc Jaha-KDI; Elvinë Sefiu-Tribuna Channel; Besim Kokollari –ICHAT; Dalina Kërqeli-YIHR dhe Lejla Selimi, OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura, nr. 22, 23 dhe 24;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë;

4. Formimi i grupit punues për hartimin e Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit;
5. Diskutim i Komisionit lidhur me kërkesën e zëvendësit të Avokatit të Popullit, z. Bogoljub Staletoviq.

I ftuar: Avokati i Popullit, z. Ilmi Jashari.

6. Të ndryshme.

Kryesuesja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nr. 22, 23 dhe 24

Kryetarja konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura, më 15.9.2015 dhe 21.9.2015, u miratuan pa vërejtje, kurse në procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 7.10.2015, deputetja Salihe Mustafa theksoi se në takimin e kaluar i është përgjigjur anëtarit të Komisionit Kujtim Pacaku në pyetjen rreth numrit të personave të verbër të punësuar, se në vizita të monitorimit ka mundur të marrë pjesë secili anëtar i Komisionit dhe kjo pyetje nuk i është bërë institucioneve të cilat i kanë vizituar, por kanë mundësi përmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ta marrin këtë informacion.

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 7.10.2015, u miratua me vërejtjen e deputetes Salihe Mustafa.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë

Kryetarja, tha se projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për lirinë fetare në Kosovë, anëtarëve të Komisionit u është shpërndarë me kohë dhe se në projektligj janë edhe propozimet e komuniteteve fetare, që disa nga ato janë marrë parasysh. Ajo tha se në vazhdim do të mbahen dëgjime publike dhe aktivitete të tjera, mirëpo, fillimisht, ata duhet që të pajtohen në miratimin në parim të këtij projektligji.

Salihe Mustafa, duke u ndërlidhur, theksoi se ky projektligj i plotëson kushtet për miratim në parim nga Komisioni dhe pas miratimit në parim nga Kuvendi, të formojnë grupin punues për shqyrtim dhe amendamentim të këtij projektligji.

Kryetarja, tha se duhet të jetë në ligj zyra për bashkësi fetare, që do të kujdeset për zbatimin dhe regjistrimin e bashkësive fetare, të cilat i saktëson ligji. Ajo ishte e mendimit që projektligji i plotëson kushtet për miratim në parim.

Kryetarja konstatoi se pas debatit lidhur me këtë çështje, Komisioni, me votim unanim të anëtarëve, miratoi këtë

REKOMANDIM

Të miratohet, në parim, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë.

4. Formimi i grupit punues për hartimin e Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit

Kryetarja, lidhur me këtë pikë, theksoi se Ligji për Avokatin e Popullit është miratuar në muajin qershor të vitit 2015 dhe ka hyrë në fuqi në muajin korrik. Ky ligj i obligon institucionet përkatëse për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe Komisioni është i obliguar që ta hartojë Rregulloren për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit, andaj lidhur me këtë, tha se duhet të formohet një grup punues, në mënyrë që të merret më konkretisht me këtë rregullore dhe kërkoi që fillimisht të paraqiten vullnetarisht anëtarët që dëshirojnë të jenë pjesë e këtij grupi punues.

Pas një debati në mes anëtarëve të Komisionit lidhur me këtë çështje, Komisioni nxori këtë

VENDIM

Për formimin e grupit të punues për hartimin e Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit.

1. Formohet grupi i punës për hartimin e rregullores, në këtë përbërje:

Lirije Kajtazi, kryesuese,
Salihe Mustafa, anëtare, dhe
Kujtim Paçaku, anëtarë.

5. Diskutim i Komisionit lidhur me kërkesën e zëvendësit të Avokatit të Popullit, z. Bogoljub Staletoviq, i ftuar Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari

Kryetarja, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se ata kanë ftuar Avokatin e Popullit, z. Hilmi Jashari, mirëpo në pamundësi të ardhjes së tij, ai ka deleguar zëvendësin e tij, z. Isa Hasani.

Ajo, në vazhdim, e njoftoi zëvendësin e Avokatit të Popullit se çështja ka të bëjë me kërkesën e zëvendësit të Avokatit të Popullit, Bogoljub Staletoviq, që është diskutuar mjaft gjatë dhe i ka kaluar edhe afatet ligjore, për shkak të shumë rrethanave. Ajo, po

ashtu, theksoi se me kërkesë të Komisionit, lidhur me këtë çështje, kanë marrë një përgjigje nga Zyra Ligjore e Kuvendit. Ajo pyeti zëvendësin e Avokatit të Popullit se pse ende nuk është bërë shpallja e konkursit për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit, pasi që ligji ka kohë që është miratuar dhe u ka skaduar mandati të gjithë zëvendësve.

Isa Hasani, pasi përshëndeti të pranishmit, tha se nga tetori i vitit 2014, ata janë pa mandate, mirëpo e ushtrojnë funksionin e tyre, deri në zgjedhjen e zëvendësve të tjerë, pasi që këtë përcaktim e bën Ligji për Avokatin e Popullit. Lidhur me obligimin e Institucionit të Avokatit të Popullit për nxjerrjen e Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e zëvendësve të Avokatit të Popullit, theksoi se Avokati i Popullit, z. Hilmi Jashari, pas miratimit të Ligjit për Avokatin e Popullit, menjëherë ka formuar gupin punues për hartimin e Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e zëvendësve të Avokatit të Popullit. Ai, po ashtu, informoi Komisionin se kjo rregullore është hartuar nga grupi punues dhe po presin që t'ia përcjellin Komisionit, në mënyrë që të evitohet çfarëdo kolizioni ligjor, në këtë drejtim. Gjithashtu, ai i njoftoi anëtarët e Komisionit se ata kanë përgatitur konkursin dhe presin që shumë shpejt të shpallet konkursi dhe të procedojnë me hapat tjerë në vazhdim.

Kryetarja, lidhur me këtë, tha se në bazë të ligjit të ri, ata kanë më shumë kompetenca në këtë drejtim, sepse e kanë mundësinë që edhe pa procedurat e konkurrimit, të propozojnë zëvendësit që e kanë mandatin e dytë. Lidhur me këtë çështje, ajo kërkoi mendimin e drejtorit, Xheladin Hoxha.

Xheladin Hoxha, lidhur me kërkesën e zëvendësit të Avokatit të Popullit, Bogoljub Staletoviq, theksoi se është diskutuar një kohë të gjatë, i cili ka kërkuar që të evidentohen shkeljet eventuale të Avokatit të Popullit, në këtë rast. Ai, po ashtu, theksoi se në bazë të përcaktimeve ligjore, Avokati i Popullit bën propozimin për shkarkim, ndërsa Kuvendi është kompetent për shkarkimin e zëvendësve të tij. Kjo ka ndodhur në kohën kur Kuvendi ka qenë i shpërberë dhe nuk është konstituuar deri në muajin dhjetor të vitit 2014. Në këtë kohë, zëvendësve iu ka kaluar mandati dhe nuk ka mundësi as Kuvendi që t'i shkarkojë zëvendësit, të cilëve iu ka skaduar mandati. Ai, në vazhdim, theksoi se Avokati i Popullit është vonuar në shpalljen e konkursit, gjë që do të kishte ndikuar në ndryshimin e kësaj situate. Lidhur me rastin e zëvendësit Staletoviq, ai theksoi se gjykata është ajo që vendos, nëse ka pasur shkelje apo jo dhe në ato raste vendos edhe për kompensimet e pagës së zëvendësit, nëse është konstatuar shkelja nga Avokati i Popullit.

Isa Hasani, duke u ndërlidhur me këtë, theksoi se është e vërtetë se Institucioni i Avokatit të Popullit është vonuar pak për shpalljen e konkursit, por kanë ndikuar disa faktorë, duke e përfshirë edhe emërimin rishtas të Avokatit të Popullit në këtë pozitë, pastaj miratimi i ligjit të ri dhe imponimi i procedurave të tjera. Të gjitha këto kanë ndikuar në vonesa. Lidhur me rastin Staletoviq, ai theksoi se gjykata është ajo që do të vendosë lidhur me rastin.

Kujtim Paçaku, tha se ata nuk e dinë se deri ku ka arritur zhvillimi i procedurës gjyqësore, si dhe çfarë vendimi do të merret lidhur me këtë rast. Ai shprehu mendimin se duhet të zhvillohet procedurë në mënyrë më të shpejt, sepse po të zvarritet, do të humbet mjaft kohë për këtë rast.

Salihe Mustafa, theksoi se këtë çështje e kanë diskutuar një kohë relativisht të gjatë dhe për të qenë më preciz, kanë kërkuar mendim nga Zyra ligjore, përfaqësuesit e të cilës kanë përgatitur shkresën, si dhe kanë marrë pjesë personalisht në takim. Ajo ishte e pajtimit që lënda të përfundojë në këtë mënyrë.

Kryetarja konstatoi se pas një debati të gjerë lidhur me këtë rast, Komisioni nxori këtë

P Ë R F U N D I M

Komisioni nuk mund ta procedojë propozimin e Avokatit të Popullit për shqyrtim në Kuvend, pasi që zëvendësve të Avokatit të Popullit, që nga tetori i vitit 2014, u ka skaduar mandati, andaj nuk mund të bëhet një veprim i tillë në Kuvend. Po ashtu, lënda është në procedurë gjyqësore dhe Komisioni nuk ka të drejtë të ndër marrë veprime, përderisa një lëndë është në procedurë gjyqësore.

I Rekomandohet Institucionit të Avokatit të Popullit, që të shpejtojë procedurat për shpalljen e konkursit për zgjedhjen e zëvendësve të Avokatit të Popullit.

6. Të ndryshme

Kryetarja i njoftoi anëtarët e Komisionit se më datën 23 dhe 24 nëntor, ka marrë një ftesë për një konferencë rajonale, që do të mbahet në Bosnjë dhe Hercegovinë. Po ashtu, kërkohet që Kosova të prezantohet me dy persona, ndërsa për temë ka rolin e komisioneve për të drejtat e njeriut. Ajo propozoi anëtarin e Komisionit, znj. Mexhide Mjaku- Topalli.

Mexhide Mjaku- Topalli, shfaqti pakënaqësinë e saj lidhur me formën e ftesës që i ka arritur Komisionit, përkatësisht për gjuhën që ata do të deklarohen në konferencë, sepse është vetëm gjuha angleze dhe serbe. Ajo kërkoi që t'i bëhet kërkesë Kuvendit të Bosnjës që të futet edhe gjuha shqipe, pasi që ata do të prezantojnë Kosovën në gjuhën shqipe.

Kryetarja, tha se e kanë kërkuar këtë dhe presin që të sigurohet përkthimi në gjuhën shqipe.

Mexhide Mjaku- Topalli, theksoi se nëse sigurohet përkthimi në gjuhën shqipe, ajo do të marrë pjesë, në të kundërtën, nuk do të marrë pjesë, sepse kjo është diskriminuese.

Kryetarja, lidhur me këtë tha se Komisioni duhet t'i përfundojë procedurat që i takojnë e pastaj të presin për përgjigje. Lidhur pjesëmarrjen, u dakorduan që në Bosnjë të marrin pjesë Mexhide Mjaku - Topalli dhe Etem Arifi.

Po ashtu, ajo i njoftoi anëtarët e Komisionit se më 4 nëntor, Komisioni do të vizitohet nga z. Randy Berry, i dërguar special nga SHBA, i ngarkuar me çështjet e komunitetit LGBT dhe takimi me anëtarët e Komisionit do të bëhet në orën 10:00.

Po ashtu, njoftoi anëtarët e Komisionit se është mbajtur tryeza për promovimin e Ligjit për barazi gjinore, që kanë rezultuar debate dhe qëndrime të mirëpritura dhe i falënderoi anëtarët e Komisionit për pjesëmarrje. Gjithashtu, kërkoi nga administrata e Komisionit që t'ua përcjellin listën e ekspertëve që Komisioni mund t'i angazhojë, me qëllim të shqyrtimit sa më të mirë të projektligjeve që duhet t'i shqyrtojë Komisioni.

Salihe Mustafa, kërkoi që sot të miratohet në parim edhe Projektligji për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, në mënyrë që mos të humbin kohë, duke marrë parasysh edhe gjendjen e kësaj kategorie.

Kryetarja njoftoi se tani janë pa kuorum dhe nuk kanë mundësi që ta miratojnë këtë propozim të anëtares së Komisionit.

Mexhide Mjaku- Topalli, kërkoi që në takimin e radhës, të procedohet për miratim Udhëzuesi për peticione, në mënyrë që të përfundojnë procedurat lidhur me këtë.

Kryetarja, lidhur me Udhëzuesin për peticione, i njoftoi anëtarët e Komisionit se zvarritja ka rrjedhur, si pasojë e vonesës së përkthimit të këtij udhëzuesi.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije Kajtazi

